



Pranuar / Dorozuar Pamjena / Predato Received / Delivered	09.03.2023	3	viti god
Organ / Mjesia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shitja e Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTJK	2536/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.135/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.135/2023 të datës 24.01.2023, të parashtruar nga ankuesi.

kundër Vendimit Nr.01-2023 të datës 10.01.2023 të Institucionit të Avokatit të Popullit, në çështjen juridike “ *transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.135/2023 të datës 24.01.2023 të ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 01.12.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës e cila është regjistruar me shenjën A.nr.1085/2022 dhe numër protokoli: 7531/2022, kundër Vendimit V.nr.04/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe po ashtu me datë 24.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës e cila është regjistruar me shenjën A.nr.135/2023 dhe numër protokoli: 735/2023, kundër Vendimit Nr.01-2023 të datës 10.01.2023 të Komisionit të Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Bazuar në kërkesën e kryeartit të Kolegjit të Këshillit të datës 13.01.2023, Kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 të datës 13.01.2023 përmes të cilit ankesat e ankuesit A.nr.1085/2022 dhe A.nr.135/2023 i ka bashkuar në një, dhe atë nën shenjën A.nr.135/2025 pasi që parashtruesi i ankesave ishte i njëjtë, ndërsa objekti i shqyrtimit sikurse edhe baza ligjore në të dy rastet është e njëjtë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon me rastin e transferimit të tij, institucioni punëdhënës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material sikurse edhe të akteve të brendshme normative në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të dy rastet ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Institucionin e Avokatit të Popullit, ndërsa më datë 15.12.2022 dhe datë 03.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës, me theksin e veçantë se Këshilli duhet të respektojë aktet e brendshme normative të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe se këshilla juridike ankimore, ankuesit i është dhënë në pajtim me këto akte.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ankesës së ankuesit ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 24.01.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 04.09.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit; Shkresën e datës 28.08.2017 të ankuesit; Raportin mjekësor të datës 25.08.2017; Udhëzimin mjekësor të datës 25.07.2017; Raportin mjekësor të datës 25.08.2017; Vërtetimin e datës 25.08.2017 me numër protokolli:315/2017; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit të datës 04.09.2017; Shkresën e datës 27.10.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit; Ankesën e ankuesit të datës 07.12.2022 të parashtruar në Komisionin për Ankesave; Vendimin Nr.324/2022 të datës 06.12.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të IAP; Vendimin V.nr.01/2023 të datës 10.01.2023 të Komisionit të Ankesave të IAP; Rregulloren Nr.03/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit të datës 05.07.2022 me strukturën organizative; Vendimin e datës 20.12.2022 me numër:344/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Shtojcës 1 të Rregullores nr.03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit me strukturën organizative; Vendimin VK/2023 të datës 13.01.2023 të Kryetarit të Këshillit Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.02.2023; Përgjigjen e datës 03.03.2023; Përgjigjen e datës 15.12.2022; Ankesën e ankuesit të datës 01.12.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.135/2023 të ankuesit *është pezullohet, sepse:*

Kolegji i Këshillit, nga shkresat e administruara të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 04.09.2017 është i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit në pozitën e punës "Zyrtar i Burimeve Njerëzore", ndërsa përmes Vendimit Nr.324/2022 të datës 06.12.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit transferohet në pozitën e punës "Zyrtar i Depos". I njëjti kundër vendimit për transferim me datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave, ndërsa me datë 10.01.2023 Komisioni i Ankesave nxjerr Vendimin V.nr.01/2023 duke e refuzuar ankesën e ankuesit, me këshillën e dhënë juridike se ankuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mirëpo ndaj të njëjtit vendim ankuesi parashtron ankesë në Këshill.

Prandaj, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetues në rastin nr. KO171/18 të datës 20.05.2019 me Nr.Ref:AGJ11363/2019, nenit 32 të Ligji Nr. 05/L -019 Për Avokatin e Popullit, Aktgjykimin



AA.nr.387/2022 të datës 22.11.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.566/2022 të datës 14.02.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ka kompetencë të plotë lëndore të shqyrtojë dhe vendosje lidhur me ankesën e ankuesit

Mirëpo, nga se u tha si më lartë, ankuesi Hakif Imeri lidhur me të njëjtën çështje juridike-transferimin e tij nga pozita "Zyrtar i Burimeve Njerëzore" në "Zyrtar i Depos", ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes padisë së datës 24.01.2023 ndaj palës së paditur-Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe kjo çështje është konfirmuar përmes Aktvendimit A.nr.160/2023 të datës 10.02.2023 të pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, andaj në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", Kolegji i Këshillit vendos që të pezullojë procedimin administrativ të iniciuar përmes ankesës së ankuesit A.nr.135/2023 derisa gjykata respektive të vendos për çështjen konkrete në konfliktin administrativ.

Kolegji i Këshillit duke u mbështetur në neni 101.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thekson faktin se Këshilli ka mandat të plotë ligjor dhe kushtetues për të shqyrtuar të gjitha ankesat e ankuesve të cilët i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil që ndërlidhet me marrëdhënien e tyre të punës, e në rastin konkret një çështje të tillë gjenë zbatim pikërisht edhe në nenin 32 të Ligji Nr. 05/L -019 Për Avokatin e Popullit, kompetencë kjo e njohur edhe përmes dy aktgjytimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës të cilat u theksuan si më lartë, prandaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit pezullim i lëndës së ankuesit u bë duke respektuar hierarkinë institucionale dhe vendimmarrëse që ka gjykata respektive ndaj Këshillit, ndërsa pezullim i lëndës sipas këtij vendimi nuk lënë të nënkuptojë që Këshilli nuk ka kompetencë lëndore të shqyrtojë ankesën e ankuesit sikurse pretendon Institucioni i Avokatit të Popullit, duke i dhënë ankuesit këshillin juridike për në Gjykatën Themelore në Prishtinë bazuar në aktet e brendshme normative të Institucionit të Avokatit të Popullit e që lidhur me të drejtën ankimore të nëpunësit nuk janë në pajtueshmëri me frymën e Ligjit Nr. 05/L -019 Për Avokatin e Popullit, gjegjësisht nenit 32 paragrafi 1 dhe 2 të tij.

Kolegji i Këshillit bazuar në konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimin, me rastin e përfundimit të rrethanave të cilat kanë shërbyer për të pezulluar këtë çështje administrative, do të aktivizojë lëndën dhe do të vendos meritorisht.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.135/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit;
- Udhëheqësit të Personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit;
- Znj. Liridona Ajeti Kajtazi, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,

